



Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 16.12.2020

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 15.12.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Kosova Asfalt" për aktivitetin: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni lagja Vakovc" me Nr. të Prok: 616 20 030 511 nxjerr:

V E N D I M

1. Refuzohet kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Kosova Asfalt" e datës 15.12.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ndertimi i rruges nga Flotacioni lagja Vakovc" me Nr. të Prok: 616 20 030 511 kundër njoftimit të vendimit të AK –së, të datës 10.12.2020 të publikuara në web-faqe të KRPP-së.

2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin sipas publikimit të datës 10.12.2020 .

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik "Kosova Asfalt" me datë 15.12.2020 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndertimi i rruges nga Flotacioni lagja Vakovc" me Nr. të Prok: 616 20 030 511 .

Autoriteti Kontraktues, me datë 16.12.2020, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimet tuaja janë të bazuara vetëm në një pikë që ka bërë lidhur me kërkimin e sqarimeve plotësuese për licencat e armirueseve dhe latueseve, respektivisht ka të bëjë me faktin se bashkë me Njoftimin për Vendimin e Autoritetit Kontraktues është ngritur Njoftimi për eliminim tuaj nga vlerësimi paraprak ku shënohet se tenderi juaj është refuzuar për këto mangësi. Ju sqaroj se këtu kemi të bëjmë me gabim teknik gjatë publikimit të dokumenteve në E-prokurim, pasi që arsyeja e refuzimit të tenderit tuaj është krejtësisht tjetër dhe e bazuar në Vendimin e OSHP-se. Që të jemi me të qartë Paneli Shqyrtues në Vendimin e vet ka konstatuar si vijon:

Bazuar në këto komisioni i vlerësimit në raportin e vet ka konstatuar si vijon:

-Konzorciumi i Operatorëve Ekonomik "Kosova Asfalt shpk, Agim Morina" nuk e plotëson kriterin e kërkuar të FDT-ës për armirues dhe për latues të certifikuar, ka dorëzuar certifikata të trajnimit për siguri dhe shëndet që nuk e plotësojnë kriterin e kërkuar. Edhe pse për armiruesit dhe latuesit kemi mundur të kërkojmë sqarime një gjë të tillë nuk e kemi kërkuar pasi që Deklarata nën Betim e OE "Kosova Asfalt" është e pavlefshme pasi që në këtë deklaratë figuron emri dhe mbiemri i Bujar Shabanit i cili është edhe pronar i kompanisë Bageri kurse jo i kompanisë "Kosova Asfalt" e pronar është Valdrin Shabani kurse nënshkrimi është i Valdrin Shabanit.

Duke u bazuar në nenin 87, paragrafi 2.7 i Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.04/L-237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05/L-092 sa i përket kësaj çështje KRPP ofron interpretim ligjor si në vijim: citojmë:

"Të drejtën e nënshkrimit nga një person në emër të një personi tjetër në dosjen e tenderit dhe deklaratat nën betim pa një autorizim nga personi kompetent, nuk e rregullon Ligji për Prokurim Publik dhe as legjislacioni dytësor i Prokurimit Publik. Megjithatë, për derisa në Formularët standard të Dosjes së Tenderit përfshirë deklaratën nën betim dhe dokumentet tjera, kërkohen të dhëna mbi identifikimin e OE (siq janë: emri dhe mbiemri, pozita, nënshkrimi, data dhe vula) pra kërkohet të plotësohen dhe të nënshkruhen nga përfaqësuesi i Operatorit Ekonomik (dhe jo nga një

person që nuk është kompetent dhe nuk ka autorizim për ta bërë një gjë të tillë).

KRPP, konsideron se nënshkrimi “për” në emër të përfaqësuesit të OE nga një person që nuk ka autorizim për një gjë të tillë ,nuk mund të jetë I pranueshëm”

Për këtë arsye konzorciumi “Kosova Asphalt shpk& Agim Morina” është I papërgjegjshëm.

Pra kjo është arsyeja baze e refuzimit të tenderit tuaj e konstatuar nga Vendimi i OSHP-se dhe komisioni për rivleresim dhe për këtë nuk janë kërkuar sqarime shtesë, pasi që asnjë sqarim nuk do të mund ta ndryshonte statusin e tenderit tuaj.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lartë ka vendosur si në dispozitiv.

Vendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës , departamentit të prokurimit dhe njësis së kërkesës.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.


Zyrtari përgjegjës i Prokurimit